


# Krimi i urrejtjes anti-myslimane



# Krimi i urrejtjes anti-myslimane

Brenda rajonit të OSBE-së, myslimanët dhe komunitetet e tyre janë pikësynim i retorikës e cila orvatet të stigmatizojë ata, t'i zhvlerësojë kontributet e tyre dhe ta mohojë përkatësinë e tyre në shoqëri. Nëse nuk kontrollohet, kjo atmosferë e jotolerancës mund të çojë drejt krimeve të urrejtjes anti-myslimane, duke përfshirë dhe sulmet fizike kundër atyre që dukshëm janë myslimanë, dhe drejt vandalizimit të dyqaneve, restoranteve dhe bizneseve të tjera në pronësi të myslimanëve. Krimet e këtilla shkaktojnë frikë në mesin e komuniteteve të synuara, duke detyruar kështu myslimanët të fshehin identitetin e tyre dhe të ndryshojnë rutinat e tyre. Vetëm një reagim i fuqishëm nga të gjithë vepruesit në shoqëri mund të sfidojë në mënyrë efektive diskriminimin, jotolerancën dhe krimet e urrejtjes kundër myslimanëve.

## Ç'është krimi i urrejtjes?

**Vepër penale + Motivim nga paragjykimi = Krim urrejtjeje**

- Krimet e urrejtjes përbëhen nga dy elemente: vepra penale dhe motivimi nga paragjykimi.
- Së pari, për t'u kryer një krim i urrejtjes, duhet të jetë kryer një kundërvajtje bazë. Me fjalë të tjera, vepra e kryer duhet të paraqesë një kundërvajtje, sipas së drejtës penale. Nëse nuk ekziston një vepër penale, atëherë nuk ekziston as krimi i urrejtjes.
- Elementi i dytë i krimit të urrejtjes është se kryerësi duhet të kryejë një vepër penale me një apo më shumë motive konkrete nga paragjykimi (të tilla si paragjykimi ndaj aftësisë së kufizuar, fesë, etnisë, ngjyrës së lëkurës dhe/ose gjinisë së viktimës). Prania e motivit nga paragjykimi është ajo që i dallon krimet e urrejtjes nga krimet e tjera.
- Një krim i urrejtjes është kryer në rastet kur kryerësi me qëllim ka synuar një individ apo pronë për shkak të një apo më shumë veçorive të mbrojtura, ose ka shprehur

armiqësi ndaj veçorisë(ve) të mbrojtur(a) gjatë kryerjes së krimin.

## Çka janë krimet e urrejtjes anti-myslimane?

Sulmet apo kërcënime kundër njerëzve për shkak të identitetit të tyre aktual ose të perceptuar mysliman, ose synimi i personave apo pronave që lidhen me myslimanë apo komunitete myslimane, paraqesin krime të urrejtjes anti-myslimane. Paragjykimi manifestohet ose në përzgjedhjen e pikësynimit (siç është një biznes në pronësi të myslimanëve, përfshirë një dyqan ose restorant, apo një xhami), ose në armiqësi anti-myslimane që shprehet gjatë kryerjes së krimin.

Krimet e urrejtjes anti-myslimane paraqiten kudo në rajonin e OSBE-së. Njohja e madhësisë dhe natyrës së problemit është hapi i parë drejt luftimit efektiv të tij.

Krimet e urrejtjes kundër myslimanëve shpesh intensifikohen pas sulmeve terroriste, si dhe gjatë përvjetorëve të sulmeve të



Dermana Sheta, Këshilltare e ODIHR-it për Luftimin e Jotolerancës dhe Diskriminimit ndaj Myslimanëve, duke folur me pjesëmarrës në Forumin e Aktivistëve Rinor, organizuar nga ODIHR-i, Varshavë, më 24 shtator 2019. (OSBE/Piotr Markowski)



Pjesëmarrësit mbledhen në një tubim në Mineapolis për të dënuar gjuhën e urrejtjes dhe krimet e urrejtjes kundër myslimanëve, Shtetet e Bashkuara, 17 shtator 2016. (Flickr/Fibonacci Blue)

tilla. Të dhënat që i dërgohen ODIHR-it dëshmojnë modelet e sulmeve anti-myslimane kundër pronës gjatë lutjeve të së premtes (xhumasë) dhe festave fetare, dhe shpesh përfshijnë mbishkrime ose mbetje të derrave që lihen para xhamive, qendrave të komunitetit dhe shtëpive të familjeve myslimane. ODIHR-i po ashtu pranon raporte të shumta çdo vit mbi sulme kundër grave që mbajnë shami, që është një shembull i krimit të urrejtjes i motivuar nga paragjykime të shumëfishta (në bazë të fesë dhe gjinisë së viktimës). Kjo nënvizon nevojën për të marrë një qasje holistike dhe shumë-dimensionale në adresimin e krimeve të tilla, duke marrë në konsideratë identitetet e shumëfishta të viktimave.

Duke ditur drejtimet dhe lëvizjet e shumta fetare që përbëjnë Islamin, krimet e motivuara nga paragjykimi kundër myslimanëve mund të marrin shumë forma të ndryshme. Viktimat mund të vihen në shënjestër për shkak të besimit të tyre mysliman, ose për shkak se besimi i tyre është i lidhur me një drejtim tjetër të Islamit sesa ai i autorit të krimit, ose sepse lëvizja e tyre fetare identifikohet me një grup konkret etnik.

Që nga viti 2002, Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së në mënyrë të prerë i kanë dënua veprat e diskriminimit dhe dhunës kundër myslimanëve, dhe fuqishëm e kanë refuzuar identifikimin e terrorizmit dhe ekstremizmit me cilëndo fe apo kulturë.

Deklarata e Astanas e vitit 2010 thekson se zhvillimet ndërkombëtare dhe çështjet politike nuk mund të justifikojnë asnjë formë të jotolerancës ose diskriminimit ndaj myslimanëve, dhe inkurajon Shtetet pjesëmarrëse të sfidojnë paragjykimet dhe stereotipet anti-myslimane.

## Si të identifikojmë krimet e urrejtjes anti-myslimane

Ka një numër treguesish që mund të ndihmojnë në identifikimin e një paragjykimi anti-mysliman në një krim të mundshëm të urrejtjes. Tregues të tillë, të njohur si “tregues të paragjykimit”, mund të nxisin autoritetet të hetojnë një krim si krim të urrejtjes anti-myslimane, duke mundësuar kështu një përgjigje të përshtatur.

Pyetjet e mëposhtme mund të ndihmojnë në identifikimin e krimeve të urrejtjes anti-myslimane:

- A e perceptojnë viktimat ose dëshmitarët incidentin si të motivuar nga paragjykimi kundër myslimanëve ose Islamit?
- A ka pasur komente, deklarata me shkrim, gjeste apo mbishkrime që dëshmojnë për një paragjykim? Këtu mund të përfshihen komente që barazojnë myslimanët me terrorizëm, imazhe dhe gjuhë që lidhen me kryqëzatat, ose simbole që promovojnë mbrojtjen e fesë apo shtetit të kryerësit, të tilla si flamuj kombëtarë ose kryqe.
- Në rast të sulmit kundër pronës, a është perceptuar një gjësend si fyes për myslimanët, të tilla si mishi i dërrit apo gjaku, që janë lënë në vendngjarje? Apo a është përdhosur një gjësend i rëndësishëm fetar, siç është një libër Kur’ani?
- A ishte prona e shënjestruar një lokacion me rëndësi fetare apo kulturore, si për shembull xhami, varrezë myslimane, ose shkollë?
- A ishte prona e shënjestruar një dyqan, njësi banimi apo ndërtesë që lidhet me myslimanët, apo një tokë e përzgjedhur për ndërtimin e një xhamie apo Qendre Kulturore Islame?
- A ishte shënjestruar prona në fjalë më herët gjatë një incidenti anti-mysliman?

- Cila ishte natyra e sulmit? A ishin shënjestruar simbole që përfaqësojnë Islamin? Për shembull, a u hoq shamia nga koka e një gruaje, apo a u rrua mjekra e një burri mysliman?
- A i përket i dyshuari një grupi urrejtjeje që synon myslimanët? Këtu mund të përfshihen grupe të ndryshme ekstremiste djathtiste, apo grupe që avokojnë jotolerancën kundër myslimanëve. A tregon prejardhja ose evidenca penale e të dyshuarit se ka kryer vepra të ngjashme në të kaluarën, përfshirë edhe kundër grupeve të tjera?
- A është i dyshuari anëtar i një grupi të ndryshëm nga ai i viktimës?
- A ishte viktima e veshur me veshje apo me veçori që shpesh lidhen me Islamin apo të qenit mysliman, të tilla si, për shembull, një grua që mban shami, apo një burrë me mjekër, një person i veshur me rroba të gjata ose me shkrime në gjuhën arabe në rrobat apo stolitë e tij, apo a ka personi një emër tingëllues mysliman? A është perceptuar viktima gabimisht si mysliman për shkak të veshjes së saj (p.sh. një grua hebreje e veshur me shami, ose një burrë sik që mban turban (çallmë))?
- A ishte viktima udhëheqës i komunitetit mysliman, apo mbrojtës i të drejtave të njeriut që merret me mbrojtjen dhe sigurinë e myslimanëve?

- A ndodhi incidenti në ditët pas një sulmi terrorist, në përvjetorin e një sulmi të tillë ose më një datë tjetër me rëndësi qoftë për autorin e krimit ose për komunitetet myslimane? A ndodhi incidenti gjatë një feste myslimane, ose përgjatë një fushate politike?
- A ka ndonjë motiv tjetër që është i qartë? Mungesa e motiveve tjera është gjithashtu një arsye për të marrë në konsideratë motivin nga paragjykimi.

Krimet e urrejtjes anti-myslimane duhet të monitorohen dhe evidentohen si një kategori e veçantë e krimit për të mundësuar një përgjigje të përshtatur. Të dhënat për krimet të tilla duhet të ndahen sipas gjinisë, për të kuptuar më mirë shkallën në të cilën gratë dhe burrat preken nga krimet e urrejtjes anti-myslimane dhe për të zhvilluar përgjigjet e duhura. Krimet e urrejtjes anti-myslimane shpesh kategorizohen gjerësisht në statistikatat zyrtare si krimet të urrejtjes anti-fetare ose janë të ndërlidhura me krimet të urrejtjes anti-arabe ose anti-emigrante. Kur një krim kryhet me motive të shumëfishta nga paragjykimi, secili prej këtyre paragjykimeve duhet të evidentohet dhe adresohet gjatë hetimit dhe ndjekjes penale.

## Shembuj të krimeve të urrejtjes anti-myslimane

- Gjashtë persona mbetën të vvarë dhe 19 të plagosur kur një kryerës i armatosur hyri në xhami gjatë lutjes dhe qëlloi me armë besimtarët. Kryerësi më herët kishte shprehur simpatinë e vet për lëvizjet ekstremiste djathtiste, anti-myslimane dhe lëvizjet për epërsinë (supremacinë) e të bardhëve.
- Një grua që mbante shami u fye, dhe iu tha: “kthehu në shtetin tënd” dhe u sulmua fizikisht. Kryerësi ia theu asaj një gisht dore dhe ia hoqi shaminë.
- Një xhami u shënjestrua në një sulm zjarri, ku shtatë kockeje Molotov u hodhën në drejtim të objektit.
- Kokë derrash dhe kavanoza të mbushur me gjak u lanë në një tokë ku ndërtohej një xhami. E njëjta tokë ishte vandalizuar disa javë më parë.

## Raportimi i krimeve të urrejtjes anti-muslimane

Krimet e urrejtjes kundër muslimanëve, njëjtë si të gjitha krimet e urrejtjes, nuk raportohen mjaftueshëm, dhe kjo mund të jetë për një larmi arsyesh. Viktimave mund t'u mungojë besimi tek autoritetet, mund të mendojnë se pretendimi i tyre nuk do të merret seriozisht, ose mund të kenë frikë nga viktimizimi plotësues nga oficerët e policisë.

Aksesi efektiv në drejtësi mbetet një sfidë vendimtare për viktimat, dhe sfidë të cilën Shtetet pjesëmarrëse duhet ta adresojnë. Qeveritë kanë rolin kryesor që duhet ta luajnë në sigurimin e aksesit në drejtësi, duke u nisur nga vlerësimi fillestar i nevojave të viktimave që duhet të përmbushen nga oficerët e policisë, e deri tek zhvillimi i mekanizmave mbështetës për viktimat.

Shumë grupe të shoqërisë civile muslimane e kanë njohur

rëndësinë e monitorimit të krimeve të urrejtjes, përfshirë si një mjet avokimi, dhe po zhvillojnë kapacitetet e tyre të monitorimit përmes punës në komunitet dhe raportimit në internet.

Për të qenë efektive, përgjigjet e policisë dhe politikat e qeverisë për të luftuar krimet e urrejtjes anti-muslimane duhet të bazohen në prova dhe të bazohen në të dhëna zyrtare mbi krimin e urrejtjes, si dhe në raportet e shoqërisë civile dhe organizatave ndërkombëtare. Ndërgjegjësimi i shtuar publik mbi krimet e urrejtjes, evidentimi i krimeve të urrejtjes nga Shtetet pjesëmarrëse, masat për inkurajimin e denoncimit nga viktimat, dhe monitorimi dhe raportimi i shoqërisë civile do të ndihmojnë zbulimin e shtrirjes së problemit në më shumë detaje, duke u mundësuar politikëbërësve të identifikojnë përgjigjet e duhura.

## Çfarë mund të bëni?

Ekzistojnë shumë organizata që ndihmojnë viktimat e krimeve të urrejtjes. Institucioni i Avokatit të Popullit dhe shoqatat që punojnë me komunitetet muslimane luajnë rolin kryesor në luftimin e krimeve të urrejtjes dhe shërbejnë si një lidhje jetike midis viktimave, komuniteteve dhe autoriteteve lokale. Ju mund të kontaktoni shoqatën tuaj lokale ose institucionin e Avokatit të Popullit për të mësuar më shumë rreth krimeve të urrejtjes anti-muslimane:




- Equinet – Rrjeti Evropian i Organeve të Barazisë: <http://www.equineteurope.org/>
- Instituti Ndërkombëtar i Avokatit të Popullit (IOI): <http://www.theioi.org>
- Rrjeti Evropian i Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (ENHRI): <http://ennhri.org/>

## Udhëzuesit e ODIHR-it për krimet e urrejtjes

ODIHR-i ka përpiluar praktika të mira nga Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së në adresimin e krimeve të urrejtjes dhe i ka ndarë ato në disa botime, të disponueshme në faqen tonë të internetit në: [www.osce.org/odihr/guides-related-to-hate-crime](http://www.osce.org/odihr/guides-related-to-hate-crime).

ODIHR-i ka botuar dhe një udhëzues praktik mbi Të kuptuarit e krimeve të urrejtjes anti-muslimane, adresimin e nevojave të sigurisë së komuniteteve muslimane, i disponueshëm në: <https://www.osce.org/odihr/muslim-security-guide>.

Mësoni më tepër rreth krimeve të urrejtjes anti-muslimane dhe mënyrës se si organizatat e shoqërisë civile mund të raportojnë incidentet tek ODIHR, duke vizituar faqen tonë të internetit të destinuar për Raportimin e Krimit të Urrëjtjes në: [www.hatecrime.osce.org](http://www.hatecrime.osce.org).



### Më shumë informacione:

Për informacione më të hollësishme rreth nismave të ODIHR-it për krimet e urrejtjes dhe për të parë gamën e plotë të burimeve dhe publikimeve, vizitoni:

[www.osce.org/odihr/tolerance](http://www.osce.org/odihr/tolerance)

### Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut

ul. Miodowa 10, 00-251 Varshavë  
Poloni

Tel.: +48 22 520 0600

Faksi: +48 22 520 0605

E-mail-i: [tninfo@odihr.pl](mailto:tninfo@odihr.pl)

